



## BASHKIA SKRAPAR

### PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

#### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Furnizim me ushqime për qendrën ditore "Midis Nesh””**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 15800000-6**

**Vlera e fondit limit: 1 522 191 (një milion e pesëqind e njëzetë e dymijë e njëqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, autoriteti kontraktor Bashkia Skrapar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26 dhe 30, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

#### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

#### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**a)** Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e ulët se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 1 dhe 2c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, pika 1, të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 Për Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Çdo tatimpagues për gatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabel, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.”*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mesipër është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

- a) Dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e zhvillimit të tenderit, në vlerë jo më të ulët se 20 % të fondit limit që prokurohet. Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme :

- Për kontrata me institucionet shtetërore për përvojën e mëparshme duhet të paraqiten vërtetime realizimi të lëshuara nga institucionet perkatese me të cilat keni realizuar kontratën, ku shënohen datat, shumat, sasitë dhe shërbimet e realizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të firmosura e të konfirmuara nga blerësi dhe shitësi ku të përcaktohen qarte, datat, shumat, sasitë dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 55, pika 4,b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

- b) Operatori ekonomik të paraqesë licencën kategorisë II.1.A.1- “Prodhim përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Licenca duhet të jetë në emër të tij pasi duhet të përkasë operatorit të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 40, pika 5, shkronja a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-së nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Paraqitja e liçences është kërkuar për të vërtetuar se operatori ekonomik ushtron aktivitet të rregullt në perputhje me legjislacionin në fuqi për fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit..

- c) Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose në përdorim kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, ambiente të përshtatshme për prodhimin dhe magazinimin e artikullit bukë si dhe licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) për artikullin bukë. Ambjentet duhet të plotësojnë kushtet higjeno-sanitare të jenë të pajisur me çertifikate pronësie (origjinal ose kopje e noterizuar) dhe leje higjeno-sanitare të lëshuar nga inspektoriati shëndetsor.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” piken 5 /ç te nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe bazuar ne Rekomandimin e perbashket te APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, date 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve te veçanta per kualifikim dhe specifikimet teknike per prokurimin e produkteve ushqimore”.

Me anë të këtij kriteri AK kërkon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike (furra buke ose ambiente të përshtatshme për magazinimin e bukes) për të përmbushur me sukses kontratën, nisur edhe nga natyra e produktit, që duhet të ruhet në kushte të përshtatshme higjeno-sanitare, me qëllim që të garantojnë sigurinë e produktit bukë.

- d) Operatori ekonomik të paraqesë raportin e analizës së kryer nga laboratorë të licensuar nga organet kompetente (AKU) të lëshuar jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë nga hapja e ofertave për artikullin bukë (1kg) .

**Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe pika 8, neni 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe bazuar ne Rekomandimin e përbashkët të APP-së dhe AKU-së nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve te veçanta per kualifikim dhe specifikimet teknike per prokurimin e produkteve ushqimore”.

Paraqitja e raportit të analizës është kërkuar për të vërtetuar se operatori ekonomik ushtron aktivitet të rregullt në perputhje me legjislacionin në fuqi për fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit. Ky kriter është vendosur me qëllim që të sigurojë AK për të siguruar cilësinë e ushqimit për Konviktin.

- e) Operatori duhet të ketë në pronësi ose në përdorim kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, Thertore/Njësi tregtimi të mishit/ ambiente për magazinimin. Operatori ekonomik të paraqesë liçence nga Qendra Kombëtare e Liçencimit për produktet me origjinë shtazore. Ambjentet duhet të plotësojnë kushtet higjeno-sanitare dhe të jenë të pajisur me çertifikate pronësie (origjinal ose kopje e noterizuar) dhe leje higjeno-sanitare të lëshuar nga inspektoriati shëndetsor

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në piken 5 /ç te nenit 40 të VKM nr.285 datë 19.05.2021

---

“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , si dhe bazuar ne Rekomandimin e perbashket te APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, date 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Me anë të këtij kriteri AK kërkon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike (ambiente të përshtatshme për therjen, tregëtimin dhe magazinimin e produkteve të mishit) për të përmbushur me sukses kontratën, nisur edhe nga natyra e produkteve, që duhet të ruhen në kushte të përshtatshme higjieno-sanitare, me qëllim që të garantojnë sigurinë e tyre.

- f) Operatori duhet të ketë në pronësi ose përdorim kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës Baxho/Njësi tregtimi Bulmeti/ ambiente për magazinimin e artikujve të bulmetit. Operatori ekonomik të paraqesë Licence lëshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) për artikujt e qumështit dhe nënproduktet e tij. Ambjentet duhet të plotësojnë kushtet higjieno-sanitare dhe të jenë të pajisur me çertifikate pronësie (origjinal ose kopje e noterizuar), dhe leje higjieno-sanitare të lëshuar nga inspektoriati shëndetsor

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në piken 5 /ç të nenit 40 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , si dhe bazuar ne Rekomandimin e perbashket te APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, date 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Me anë të këtij kriteri AK kërkon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike (ambjent frigoriferik të përshtatshëm për ruajtjen e produkteve të bulmetit) për të përmbushur me sukses kontratën, nisur edhe nga natyra e produkteve të bulmetit të cilat duhet të ruhen në kushte të përshtatshme higjieno-sanitare dhe teknologjike, me qëllim që të garantojnë sigurinë e produkteve të bulmetit.

- g) Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokument për pronësi ose përdorim kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara, Njësi tregtare ushqimore / fruta perime ose ambiente për magazinimin e artikujve të tjere ushqimore. Ambjentet duhet të plotësojnë kushtet higjieno-sanitare dhe të jenë të pajisur me çertifikate pronësie (origjinal ose kopje e noterizuar) dhe leje higjieno-sanitare të lëshuar nga inspektoriati shëndetsor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në piken 5 /ç të nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , si dhe bazuar ne Rekomandimin e perbashket te APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, date 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

---

Me anë të këtij kriteri AK kërkon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike (ambjente të përshtatshme për ruajtjen e frutave dhe perimeve) për të përmbushur me sukses kontratën, nisur edhe nga natyra e produkteve të bulmetit të cilat duhet të ruhen në kushte të përshtatshme higjeno-sanitare dhe teknologjike, me qëllim që të garantojnë sigurinë e frutave dhe perimeve.

h) Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose në përdorim kundrejt kontratës përkatëse të noterizuar, mjete transporti të vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës për furnizimin e ushqimeve blegtorale, si me poshtë :

- Automjet të përshtatshëm (frigoriferik ATV) për artikujt bulmet dhe mish (1 copë). Për automjetet të paraqiten certifikatat e pronësisë , kontratat e dhurimit apo të qirasë sipas rastit shoqëruar me certifikatën e pronësisë së qeradhënësit , si dhe dokumentacionin përkatës certifikatat e kontrollit teknik, lejet e qarkullimit , Siguracion të automjeteve në dispozicion, taksa e mjetit si dhe leje për transport mallrash si dhe leja higjeno-sanitare e mjetit. (dokumentacioni i kërkuar të jetë i vlefshëm në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi) .
- Operatori ekonomik duhet të disponojë automjet të përshtatshëm ATP (1 copë). Për automjetet të paraqiten certifikatat e pronësisë , kontratat e dhurimit apo të qirasë sipas rastit shoqëruar me certifikatën e pronësisë së qeradhënësit , si dhe dokumentacionin përkatës certifikatat e kontrollit teknik, lejet e qarkullimit , Siguracion të automjeteve në dispozicion, taksa e mjetit si dhe leje për transport mallrash si dhe leja higjeno-sanitare e mjetit. (dokumentacioni i kërkuar të jetë i vlefshëm në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi) .

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në pikën 5 /ç të nenit 40 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Me anë të këtij kriteri AK kërkon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike (Automjet të përshtatshëm (frigoriferik ATV për artikujt bulmet dhe mish dhe automjet të përshtatshëm ATP .) për të përmbushur me sukses kontratën, nisur edhe nga natyra e produkteve (të mishit, bulmetit dhe të frutave, perimeve) të cilat duhet të ruhen në kushte të përshtatshme higjeno-sanitare, me qëllim që të garantojnë sigurinë e tyre. Operatori ekonomik fitues do të kryejë transportin e produkteve (deri në magazinën e AK dhe njëkohësisht të garantojë ruajtjen e vlerave ushqimore të këtyre produkteve..

i) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë Çertifikatë ISO 9001-2015 ose ekuivalentin e saj, Certifikatë ISO 22000-2018 ose ekuivalentin e saj, të vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të kontratës. (Në rastet e bashkimit të operatorëve

---

ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë çertifikatat ISO sipas zërave të shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në pikën 1, të nenit 44, të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, date 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Kjo kërkesë dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë, sigurisë ushqimore.

- j) Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Vetëdeklarim ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në pikën 8, të nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, date 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Paraqitja e këtij vetedeklarimi është kërkuar për të vërtetuar se operatori ekonomik ushtron aktivitet të rregullt në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit. Ky kriter është vendosur me qëllim që ti shërbejë AK për të siguruar cilësinë e ushqimeve, që do të prokurohen.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë vendosur në bazë të Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, si dhe në përputhje në nenin 36, të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, neni 40 , pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe referuar “Katalogut Final të Ushqimeve” të publikuar në faqjen zyrtare të APP, të Njoftime 2024 ose në linkun : <https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=60df12ef-c3cd-4cc5-abe1-2aaa86fed88f>

## **NJËSIA E PROKURIMIT**

**Benis Dosti**

**Miranda Bakiasi**

**Jona Koçi**